



Viti i VII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2016

STUDIM KRAHASUES MBI SHOQËRITË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË RUMANI DHE SHQIPËRI

Eledio Lule

*Departamenti i Shkencave Juridike, Universiteti i Craiovës, Ruman

Adresë kontakti: elediol@yahoo.it

Përmbledhje

Nëpërmjet këtij artikulli synojmë të realizojmë një vështrim krahasues mbi shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si përshkruhen ato në ligjet rumune dhe në ato shqiptare, duke vënë në dukje elementet e përbashkët të krijimit dhe të vazhdimësisë, por njëkohësisht duke theksuar dhe elementet e veçanta me natyrë juridike, sociale dhe ekonomike që ndryshojnë në të dy sistemet ligjore. Në legjislacionin shqiptar trajtohen kryesisht në nenet 233 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Fjalë çelës: *vështrim krahasues, sisteme, elementet e përbashkët, legjislacionin, shoqëritë tregtare.*

COMPARATIVE STUDY ON LIMITED LIABILITY COMPANIES IN ROMANIA AND ALBANIA

Abstract

Through this article we intend to realize a comparative view on companies with limited liability as described them in the right Romanian and Albanian, noting common elements of creation and continuity, but at the same time stressing and unique elements that differ in both systems of law and state legislature dealt mainly in Articles 233 of law No. 9901, dated 14.4.2008 for traders and commercial companies.

Key words: *comparative view, systems, common elements, legislature, commercial companies.*

1. Rregullorja e shoqërive tregtare parashikuar nga Ligji nr. 31/1990

E drejta e përbashkëta në lëndën e shoqërive tregtare me personalitet juridik në Rumani është e përfaqësuar në Ligjin Nr. 31/1990 për shoqëritë tregtare, e cila rregullon me një karakter të

përgjithshëm themelimin, organizimin, funksionimin, modifikimin dhe prishjen e shoqërive tregtare. Përveç kësaj, ekzistojnë rregulla të veçanta për tipe të caktuara të shoqërive, si: ato në fushën e sigurimeve, në atë financiare, bankare apo në tregun e kapitalit.

Dispozitat e Ligjit Nr. 31/1990, si dhe rregullat e veçanta, do të plotësohen sipas rastit, ndërsa në dispozitat e Kodit Civil, të gjitha këto prezantojnë të drejtën e përbashkët për lëndën e shoqërive tregtare me personalitet juridik.

Bashkëpunimi i disa vendeve evropiane në Bashkimin Evropian përfaqësojnë bazat ligjore të cilat vendosin fillimin e procesit për harmonizimin e ligjeve kombëtare. Aktualisht, është pranuar përgjithësisht se janë bërë edhe përpjekje për integrimin e rregullave evropiane që kanë të bëjnë me shoqëritë tregtare, një integrim i filluar me miratimin e 13 direktivave të shoqërive tregtare, në përgjithësi. Këto norma të së drejtës evropiane kanë për qëllim të krijojnë një emërues të përbashkët për sistemet juridike të shteteve anëtare. Nga ana tjetër, duke u munduar të ruajnë specifikat kombëtare të çdo sistemi ligjor, është lejuar nga çdo shtet zhvendosja e direktivave përkatëse në ligjin kombëtar (1). Pas vitit 2000, institucionet e komuniteteve kanë miratuar një pozicion të ri për sa u përket rregullave të komuniteteve në të drejtën tregtare dhe kanë filluar një mbrojtje të re (2) që shfaqet në miratimin e këtyre rregullave në formën e një rregulloreje, akteve normative të aplikimeve direkte, rregullore të cilat bëhen pjesë e sistemit ligjor të shteteve anëtare që nga data e hyrjes në fuqi, pa qenë e nevojshme një zhvendosje e tyre në ligjin kombëtar (3).

Përveç Ligjit nr. 31/1990 dhe direktivave në nivel evropian, ka ndryshime në legjislacionin aktual rumun dhe në përdorimin e tij. Me fjalën “normë”, në kuptimin e nenit 1 të Kodit Civil, do të kuptojmë zakonet (traditat) dhe përdorimet profesionale. Norma përfaqëson një praktikë të tejzgatur, e cila ka një shkallë vjetërsie të përsëritshmërisë ose stabilitetit të aplikuar nga një numër i papërcaktuar tregtarësh. Ajo është përkufizuar si një rregull i sjelljes tregtare, lindur nga praktika, përsëritshmëria, e përdorur për një kohë të gjatë dhe që respektohet si një traditë ligjore e detyrueshme. Në sistemin ligjor rumun, deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil normat nuk ishin burimet formale të ligjit, nuk kishin një karakter normativ të rregullores (4). Situata ndryshoi kur neni 1 i Kodit Civil përmend qëllimisht norma nga burimet e së drejtës civile. Për më tepër, në marrëdhëniet e biznesit janë gjithnjë e më të pranishme normat tregtare, qoftë në formën e një kontrate ose të një termi të standardizuar të tipit “kushtet e përgjithshme të biznesit”, qoftë dhe në formën e disa rregullave “të praktikës së mirë”. Krijimi, modifikimi, organizimi, funksionimi dhe prishja e shoqërive tregtare që janë parashikuar kryesisht nga norma të domosdoshme, ndryshe nga përdorimet tregtare, kanë një ndryshim më të reduktuar në këto fusha.

Ndryshimi i normave si burim ligjor është akoma i kufizuar. Aplikimeve të normave i janë bashkangjitur dhe disa kufizime. Kështu që, në çështjet e parashikuara me ligj, rregullorja zbatohet vetëm në masën që parashikohet nga ligji. Por, nëse ligji nuk e parashikon, do të zbatohen normat, por në mungesë të saj do të zbatohen dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me situata të ngjashme dhe kur nuk ekzistojnë dispozita të tilla, do të zbatohen parimet e përgjithshme të ligjit.

Si të natyrshme, vetëm normat konform vendimeve publike dhe traditave të mira njihen si burime të ligjit. Barra e provës së ekzistencës dhe e përmbajtjes së rregullores vendoset nga palët e interesuara, të cilat thirren në bazë të rregullores. Për të lehtësuar barrën e provës, krijohet një hipotezë ligjore, duke iu referuar ekzistencës së traditës dhe që janë botuar në publikimet e përpiluara nga subjektet apo organet e autorizuar. Hipoteza është relative kur provohet e kundërta.

Jurisprudenca mund të jetë një burim i ligjit në lidhje me marrëdhëniet juridike, për sa i përket statutit organik të shoqërive tregtare (5). Në disa kushte, vendimet e disa gjykatave në rrethana të caktuara mund të kenë vlerën e një burimi ligjor, por më shpesh kanë vlerën e një burimi interpretues

sesa normativ (6). Është rasti i vendimeve të prononcuar nga gjykatat evropiane në zgjidhjen e çështjeve parësore. Në rastet kur aplikimet e parashikuara nga ligji evropian, duke përfshirë dhe ato nga lënda e shoqërive tregtare, gjykatat kombëtare kanë paqartësi në zbatueshmërinë ose kuptimin e disa dispozitave të akteve normative evropiane, gjykatësi kombëtar ka për detyrë të njoftojë gjykatën evropiane të interpretojë si çështje parësore normën evropiane në fjalë. Zgjidhja e dhënë nga gjykatësi evropian për zgjidhjen e çështjeve parësore, ka vlerë detyruese për gjykatat kombëtare të shtetit, për të cilat janë vënë në dijeni gjykata evropiane, si dhe për shtetet anëtare, qoftë dhe për situatën kur bie në kundërshtim me ligjin kombëtar.

Të detyrueshme janë dhe vendimet e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Për aq sa ka të bëjë me statusin e tregtarit dhe KEDNJ mund të japin vendime në këtë fushë, të cilat janë gjithashtu burime të ligjit.

Ndër vendimet e prononcuar të gjykatave kombëtare, vlera e burimit ligjor i njihet vetëm vendimeve të Gjykatës së Lartë të Kasacionit në zgjidhjen e ankimeve në interes të ligjit.

Kur Gjykata Kushtetuese bën një përjashtim antikushtetues dhe shpall një vendim i cili ka efekte *erga omnes*, dispozita ligjore e deklaruar duke qenë antikushtetuese, nuk zbatohet në një poçes të tillë, gjithashtu dhe në situata të tjera identike apo të ngjashme.

Kohët e fundit vihet re se Gjykata e Lartë ka dhënë efekte në teorinë e mëparshme të parimeve gjyqësore Î .C.C.J, duke hedhur poshtë ankesën për vetë faktin se në rastet identike apo të ngjashme gjykata është shprehur se nuk ekzistojnë motive serioze për t'u kthyer mbi zgjidhjet e mëparshme (7).

Kodi Civil përcakton një lloj rregulli për aplikimin e normave që përbëjnë burime të ligjit, rregull nga i cili nuk mund të shmangesh.

Para zbatimit të ligjit në një kuptim më të gjerë, në brendësinë e kategorisë ligjore, në rast konflikti ndërmjet normave ligjore të brendshme dhe ligjeve të Bashkimit Evropian, këto të dytat do të zbatohen me përparësi, pavarësisht cilësisë ose statutit të palëve, direktivave nga lënda e shoqërive tregtare, direktivave në fushën e paaftësisë paguese, etj., Rregullorja e Këshillit Nr. 2157/2001 për sa i përket Statutit të Shoqërisë Evropiane, një formë e shoqërisë komunitare dhe në formën e shoqërive anonime, e quajtur "*Societas Europaea*".

Gjithashtu, do të aplikohen me përparësi dhe do të zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kjo më pak e hasur në lëndën e shoqërive tregtare. Kështu, art. 4. paragrafi 2 i Kodit Civil parashikon se aty ku ekziston mosakordimi ndërmjet pakteve dhe traktateve mbi të drejtat themelore të njeriut në të cilat Rumania është pjesë, do të kenë prioritet rregulloret ndërkombëtare, përveç rastit kur Kodi Civil përmban dispozita më të favorshme.

Ligjet që vijnë si pasojë e një dispozitë të përgjithshme, të cilat kufizojnë ushtrimin e disa të drejtave civile ose kur parashikojnë dënime civile do të zbatohen vetëm në rastet e veçanta dhe të kufizuara, që janë të parashikuara nga ligji.

Nëse ligji nuk e parashikon, atëherë do të aplikohen normat, por në mungesë të tyre, dispozitat ligjore për situata të ngjashme dhe, kur nuk ekzistojnë dispozita të ngjashme, do të zbatohen parimet e përgjithshme ligjore.

2. Përkufizimi dhe natyra juridike e shoqërive tregtare që parashikohen në Ligjin nr. 31/1990

Ligji nr. 31/1990 nuk përcakton një përkufizim të shoqërisë me personalitet juridik, por art. 1881 i Kodit Civil parashikon që me kontratën e shoqërisë, dy ose më shumë persona janë të detyruar në mënyrë reciproke të bashkëpunojnë për të zhvilluar një aktivitet, si dhe të kontribuojnë te kjo

shoqëri në lek, në mall, në njohje të veçanta ose në paradhënie, me qëllimin e ndarjes së përfitimeve ose t'i përdorin ato nga ekonomia që do të rezultojë.

Në literaturën e specialitetit, shoqëria tregtare u përkufizua si grupim njerëzish të formuar mbi bazën e një kontrate shoqërore, duke përfituar nga personaliteti juridik, ku ortakët kuptohen midis tyre për të vënë bashkërisht pasuri të caktuara në realizimin e një aktiviteti tregtar, si dhe ndarjen e përfitimeve të arritura (8). Ekzistenca e këtyre parashikimeve në doktrinën ligjore, çoi në ngritjen e disa pyetjeve: Shoqëria me personalitet juridik është një kontratë apo institucion? Është një kontratë, apo një person juridik? Është një kontratë apo një akt unilateral? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, janë përshkruar tri teori, për sa i përket natyrës juridike të shoqërive tregtare (9).

a. Teoria kontraktuale (10). Është ajo teori klasike, bazuar në dispozitat e nenit 1881 të Kodi Civil, i cili tregon veçanërisht se shoqëria është “një kontratë”. Në të vërtetë, shoqëria përbëhet në parim mbi bazën e një kontrate shoqërore. Ligji nr. 31/1990 përdor termat “kontratë shoqërore”, “statut”, por edhe “akti konstitutiv”. Ekzistojnë edhe situata kur shoqëria nuk ka në bazë një kontratë: është rasti i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar unipersonale, e cila është themeluar nga statuti dhe ka natyrën e një akti juridik të njëanshëm dhe jo të një kontrate.

b. Teoria institucionale (11). Në këtë teori vullneti i palëve ka rol vetëm në formimin e shoqërisë, vetëm për të vendosur themelimin e saj, duke miratuar disa rregulla pa pasur mundësi për modifikimin e tyre. Shoqëria është konsideruar një institucion sepse krijohet një subjekt i ri juridik i të drejtës private me një strukturë të pavarur; ortakët dhe aksionarët nuk mund të veprojnë përveçse në kuadër të formave statutores.

Kjo teori nuk mund të merret në konsideratë vetëm nga natyra juridike, sepse kjo do të thotë të injorosh vullnetin e palëve, pa të cilën nuk do të ekzistonte shoqëria tregtare. Megjithatë, manifestimi i vullnetit të ortakëve përbën elementin bazë të shoqërisë tregtare, aspekt i cili nuk duhet injoruar.

c. Koncepti i përbashkët. Për sa i përket këtij koncepti, shoqëria juridike ka një natyrë të dyfishtë juridike: kontraktuale dhe institucionale, vullneti i ortakëve ka një rol të rëndësishëm në krijimin e shoqërisë. Më pas, me fitimin e personalitetit juridik, shoqëria shfaqet si një grup i organizuar njerëzish, duke vepruar si një subjekt i veçantë ligjor, por duke respektuar normat ligjore që kërkojnë një sjellje të caktuar.

Duke pasur parasysh që baza e themelimit të shoqërisë është kontrata, mund të themi që shoqëria tregtare ka një natyrë kontraktuale, por me fitimin e personalitetit juridik, ajo merr dhe natyrë juridike institucionale.

Kontrata e shoqërisë, duke u bashkuar me autorizimin ligjor, përbën një përmbajtje kolektive.

Duke pasur parasysh ato që thamë më lart, veçanërisht mendimet e fundit, themi që shoqëria tregtare mund të përkufizohet si një akt juridik me natyrë kontraktuale në bazën e së cilës, pasi kalon në një procedurë ligjore të autorizuar, ajo përbën një subjekt të së drejtës, duke u dalluar nga ortakët për zhvillimin e biznesit nga pikëpamja e përfitimit (12).

3. *Format e shoqërisë tregtare që rregullohen me Ligjin nr. 31/1990*

Aktiviteti tregtar mund të realizohet, qoftë nga tregtari si personi fizik, qoftë nga bashkëpunimi i tyre në kuadrin e disa strukturave bashkëpunuese pa personalitet juridik të tipit bashkëpunim në pjesëmarrje, të shoqërive familjare, ose në formën e disa shoqërive që përfitojnë personalitet juridik, shoqëri të formuara sipas Ligjit nr. 31/1990.

Nëpërmjet nenit 2 të Ligjit 31/1990, përcaktohen 5 forma organizimi për shoqëritë tregtare në

Rumani, përkatësisht: 1. Shoqëri kolektive; 2. Shoqëri komandite të thjeshta; 3. Shoqëri aksionare; 4. Shoqëri komandite aksionare; 5. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Sipas rregullores së vjetër, Neni. 1 i këtij ligji tregon se për kryerjen e aktiviteteve fitimprurëse, personat fizikë dhe juridikë mund të marrin pjesë dhe mund të krijojnë shoqëri tregtare. E disponueshme tërësisht ndodhet dhe në lëndën e shoqërive tregtare dhe parimi kushtetues i lirisë së ortakërisë.

Ndryshe nga rregullorja paraprake e 1 tetorit 2011, aktualisht kriteri kryesor për përcaktimin e tregtisë të një shoqërie, është forma e shoqërisë. Krahas formës së shoqërisë e cila krijon një hipotezë tregtare të shoqërisë respektive për përcaktimin tregtar me karakter fitimprurës, ekziston dhe prania e rrezikut për të fituar ose për të humbur në biznes vetëm nga ana e sipërmarrësit. Ligji kufizon format mbi të cilat mund të bashkëpunojnë personat fizikë ose juridikë, duke treguar kufizimet dhe domosdoshmërinë në nenin. Nr. 2 të Ligjit nr. 31/1990 dhe pesë format ligjore që mund të marrë një shoqëri tregtare: shoqëria kolektive, shoqëria komandite e thjeshta, shoqëria komandite aksionare, shoqëria aksionare dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Vetëm organizimi në një nga këto forma shoqëria tregtare mund të fitojë personalitet juridik, kështu që ajo mund të krijohet dhe të funksionojë (13). Krijimi i një formë të re të shoqërisë, një shoqëri hibride që vjen si rezultat i kombinimit të një prej këtyre pesë formave, është i ndaluar.

Nga ana tjetër, duke qene të lirë në themelimin e saj, ortakët janë të lirë të zgjedhin dhe një prej pesë formave të shoqërive tregtare. Në mënyrë të ngjashme, gjatë funksionimit të shoqërisë tregtare, ortakët mund të zgjedhin ndryshimin e formës së zgjedhur më parë, përgjatë procedurës ligjore të stabilizuar për këtë qëllim.

3.1 Idetë e përgjithshme për SHPK-të në Rumani

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një formë e ndërmjetme, e përzierë midis shoqërisë individuale dhe asaj të kapitaleve, duke marrë hua tipare nga të dyja. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të themelohet dhe në formën e një shoqërie unipersonale me një ortak të vetëm. Kapitali i shoqërisë është minimalisht 200 lei (monedha Rumune) dhe është i ndarë në aksione me vlerë të barabartë, minimalisht 10 lei dhe të cilët nuk janë tituj të negociueshëm.

Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar vetëm në kontributin e kapitalit të shoqërisë; pagesa e detyrimeve të shoqërisë është e garantuar vetëm me pasurinë e shoqërisë. Menaxhimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar është i siguar nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, por vendimet e saj do të miratohen me shumicë të dyfishtë: shumicën absolute të ortakëve dhe aksioneve, përveç rastit kur ekziston një dispozitë e ndryshme në aktin themeltar.

Administrimi i shoqërive realizohet përmes një ose më shumë administratorëve, por kontrolli sigurohet ose direkt nga ortakët që nuk kanë cilësinë e administratorit, ose nga censorët, kur numri i ortakëve është më i madh se 15. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet qoftë nga shkaqe të përgjithshme, ashtu dhe nga shkaqe specifike.

Me ndryshimin e ligjit të vitit 2008, është rregulluar dhe shoqëria tregtare evropiane, tekst që formohet nga përmbajtja e Titullit VII të Ligjit. 31/1990. Duke u udhëhequr nga një rregullore, Rregullorja nr. 2157/2001 për shoqëritë tregtare evropiane, duke u nisur nga data e pranimit të Rumanisë në BE, dispozitat e saj kanë qenë të zbatueshme dhe nuk ishte e nevojshme përfshirja e tyre në tekstin e Ligjit nr. 31/1990.

3.2 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar në legjislacionin rumun dhe atë shqiptar

3.2.1 Formalitetet e themelimit

Faza e parë në ekzistencën e një shoqërie është vendimi i krijimit të saj nga ortakët themelues dhe në rastin kur vendimi është i përcaktuar, kjo procedurë vazhdon menjëherë me formalitetet e themelimit të shoqërisë.

	România Rumania	Albania Shqipëria
Etape de înregistrare Etapat e regjistrimit	1. Dovada verifikimi denumiri societății și rezervarea acesteia. Dëshmi e verifikimeve pentru emri e shoqërisë dhe rezervimin e saj (se eliberează pe loc – taxă de 72 lei) (Lëshohet menjëherë - taksa është 72 lei (afërsisht 15 euro)) 2. Depunerea capitalului social la o unitate bancară pentru a face dovada constituirii capitalului conform Actului constitutiv (pe loc, de regulă depozitimi i kapitalit të shoqërisë në një degë banke për të bërë dëshminë e krijimit të kapitalit në bazë të Akteve të Themelimit (në vend normalisht pa shpenzime, në varësi të njësive bankare) Ënregistrarea societății la Oficiul Registrului Comerțului (3 zile lucrătoare, taxe în valoare de aproximativ 3. Regjistrimi i shoqërisë në Regjistrin e Tregtisë (3 ditë pune, taksa në vlerë rreth 350 lei) 350 lei (afërsisht 80 euro) Ënregistrarea në scopuri de TVA, toatë celaltele formalitete dhe i nregistrare și i luare în evidență ele fiscale se transmet de ORC 4. Regjistrimi për qëllimin e TVSH-së, të gjitha formalitetet e tjera të regjistrimit, si dhe marrjen të dhënave tatimore transmetohen në Regjistrin Kombëtar të Tregtisë și i se opereazë që operojnë në mënyrë automatike nga regjistrimi i shoqërisë në Regjistrin e Tregtisë duke përfshirë caktimin e kodit tatimor (3 ditë, pa taksa) 5. Ënregistrarea contractelor angajatorëve în REVISAL – serviciu online al Inspektoriei Muncii (pe loc, procedurë online) Regjistrimi i kontratave të punonjësve në regjistrin e përgjithshëm të informimit të punëtorëve - shërbimi internet Inspektoriati i Punës (në vend, procedura në internet) 6. Ëncepand cu data de 23.07.2015 societățile române nu mai sunt obligate să aplice și tampa pe documentele ce se depun la autoritate și sau care sunt încheiate în relația dintre societate și Që nga 23.07.2015 shoqëritë rumune nuk janë të detyruara të vënë vulën në dokumentet që paraqiten në autoritetet ose që kanë përfunduar lidhjen me shoqërinë.	1. Verifikimi unicitet denumiri societății (mai puțin de o zi, procedurë online, aprox. 0,7 Eur) 1. Kontrolloni i emrit të shoqërisë (më pak se një ditë, procedura në internet, përafërsisht. 0.7 Euro) 2. Cererea de înregistrare a Certificatului de înregistrare și a numărului unic de înregistrare la Centrul Național de Înregistrare (o zi, cost: 0,7 Eur) 2. Aplikimi për regjistrimin e Certificatës së Regjistrimit dhe numrit të veçantë të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (një ditë, kushton 0.7 Eur) 3. Înregistrarea angajatorëve în Registrul Regional al Angajatorëve (o zi, fără taxe) 4. Regjistrimi i punonjësve në Regjistrin Rajonal të Punëtorëve (një ditë, pa pagesë) 5. Înregistrarea la Biroul Municipal de Venituri Interne (o zi, 268-322 Eur) 4. Regjistrimi në Zyrën Rajonale të të Ardhurave të Brendshme (një ditë, 268-322 Euro) 6. Achiziționarea de imprimat-tip pentru facturi de la autoritățile fiscale (o zi, 2,5 Euro) 5. Blerja e faturave të shtypura të nga organet tatimore (një ditë, 2,5 Euro) 7. Fabricarea ștampilei societății (o zi, 21,5 Euro) 6. Prodherimi i pullave të shoqërisë (një ditë, 21.5 Euro) Centrul Național de Înregistrare
Instituti implicate Institucionet e përfshira	Oficiul Registrului Comerțului Zyra e Regjistrimit Tregtar, Bankë, Agjencia Kombëtare e Administrimit Tatimor, Inspektoriati Territorial i Punës Banka	Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Zyra Rajonale e të Ardhurave të Brendshme, Autoritetet tatimore, Shoqëritë private të autorizuar për nxjerrjen e vulës Autoritë të fiscale

Prandaj propozojmë në rreshtat e mëposhtëm të paraqitur disa informacione të përgjithshme në të dy sistemet e ligjit rumun dhe atij shqiptar, për sa i përket themelimit të një shoqërie.

Për një ndjekje më të mirë krahasuese të formaliteteve për regjistrimin e një shoqërie tregtare me rastin e publikimit të një studimi tjetër (14) kam propozuar realizimin e një tabelë krahasuese të etapave, kostove dhe institucioneve të përfshira në krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar që do e shikojmë si më poshtë:

Duke analizuar këto të dhëna, duket se, edhe pse procedura për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri është më e shkurtër, ajo është kryesisht më e shtrenjtë sesa më të njëjtën procedurë në Rumani, dhe së dyti, përfshin më shumë institucione shtetërore në procedurën e pas-regjistrimit në regjistrin tregtar.

3.2.2 Ortakët dhe atributet e tyre

Një dispozitë e veçantë e ligjeve rumune është neni. 6 i Ligjit 31/1990, ku parashikohet ndalimi i përvetësimit të cilësisë si **ortak themelues** në një shoqëri rumune, përkatësisht: *“Personat që, sipas ligjit, janë të pa aftë ose që kanë qenë të dënuar për vepra kundër pasurisë nëpërmjet mospërfilljes së besimit, vepra për korrupsion, shpërdorim, falsifikim të dokumenteve dhe evazionit fiskal, vepra të parashikuara sipas ligjit nr. 656/2002 për parandalimin dhe ndëshkimin e pastrimit të parave, si dhe vendosjen e masave për të parandaluar dhe luftuar financimin e akteve të terrorizmit ose për veprat e parashikuara sipas këtij ligji. “*

Një ndalim i ngjashëm nuk është në ligjin shqiptar, ndërsa gjendet për anëtarët e këshillit të administratës ose këshillit mbikëqyrës të një shoqërie, si dhe përfaqësuesve të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Të dyja legjislacionet përmbajnë dispozita të ngjashme në të drejtën e ortakëve për të marrë pjesë në fitimet dhe humbjet, kryesisht në mënyrë proporcionale me kuotën e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, të dyja duke lejuar parashikimet e disa mënyrave të tjera për të ndarë përfitimet e shoqërisë nëpërmjet aktit themelues.

Elementi specifik i legjislacionit shqiptar i kësaj kohe ndodh në rastin e krijimit të disa ndalimeve suplementare për të shpërndarë fitimet e ortakëve, duke e kushtëzuar këtë ndarje, përveç ekzistimit të një përfitimi të vërtetë konform ligjeve të përcaktuara sipas bilancit fiskal, për dy aspektet respektive: a) rezervat e shoqërisë të jenë në gjendje për të mbuluar plotësisht borxhet e veta; b) shoqëria duhet të ketë mjete të transferueshme në lek, mjaftueshëm për të paguar detyrimet e arritura në skadimin e 12 muajve të ardhshëm.

Në këtë drejtim, drejtuesit mund të lëshojë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar për dividendët i përmbush këto kërkesa shtesë, në të kundërt i ndalon për të lëshuar një certifikatë të tillë dhe për më tepër, do të përgjigjet personalisht në shoqëri për vërtetësinë e kësaj certifikate të aftësisë paguese, duke përfshirë dhe rastet kur i lëshon nga neglizhenca pa përmbushur kushtet.

Me fjalë të tjera, ata do të jenë përgjegjës për kthimin e dividendëve përballë shoqërisë, nëse i lëshojnë (nga neglizhenca apo të keq besimi) certifikatat e aftësisë paguese.

Ligji rumun kufizon mundësinë për t'u përgjigjur në shoqëri vetëm për ortakët (dhe jo për administratorët) të cilët kanë arkëtuar dividendët ose në rrethana ekzistuese duhet të ketë njohur ekzistencën e disa parregullsive vetëm në procedurën e përfitimit në bazë të ligjit ose atë të shpërndarjes efektive të dividendëve.

Për sa i përket të **drejtave të përgjithshme të ortakëve**, ato janë të ngjashme në të dyja rregulloret. Kështu, ortaku si në një shoqëri shqiptare, dhe në një shoqëri rumune, përfitojnë të drejtat e

mëposhtme: **(a)** për të marrë pjesë në menaxhimin e shoqërisë në përputhje me ligjin dhe me aktin e themelimit; **(b)** për të votuar në asamblenë e përgjithshme të ortakëve; **(c)** të jenë të informuar për aktivitetet e shoqërisë; **(ç)** për të bërë verifikimet për sa i përket menaxhimit të aseteve për shoqërinë; **(d)** e drejta për dividend; **(e)** e drejta për të kërkuar përjashtimin e një prej ortakëve të tjerëve nga shoqëria; **(f)** e drejta për t'u tërhequr nga shoqëria; **(g)** për të marrë në rast të likuidimit të shoqërive vlerën e pjesëve të pronës së tij të mbetur mbas pagesës së kreditorëve dhe punonjësve në proporcion me pjesëmarrjen e saj në kapitalin e shoqërisë.

Ndër dispozitat që shënojnë **dallimet në të dy sistemet të ligjit**, numërojmë disa dispozita, disa prej të cilave të miratuara nga ligjvënësi rumun menjëherë më hyrjen në fuqi të Kodit të ri Civil, vijojnë si më poshtë:

- Ortakut nuk mund t'i bëjë konkurrencë shoqërisë për llogari të vet ose për llogari të një të personi të tretë dhe nuk mund të shpenzojë për llogarinë e vet apo për llogari të ndonjë tjetri, e cila do të ishte e dëmshme për shoqërinë. Ortaku nuk mund të marrë pjesë për llogari të vet ose në emër të një personi të tretë në një aktivitet që do t'i hiqte të drejtën e mallrave shoqërisë, në paradhënie ose njohjeve specifike në të cilën ortakut është i detyruar. Përfitimet që rrjedhin nga çdo aktivitet i ndaluar sipas dispozitave të mësipërme i kalojnë shoqërisë.
- Ortakut i pakënaqur për vendimin e marrë nga shumica mund të ankimojë në gjykatë, brenda 15 ditëve nga data në të cilën është marrë vendimi, në qoftë se ishte i pranishëm, dhe nga momenti i komunikimit nëse mungonte. Nëse vendimi nuk i është komunikuar, periudha që merret parasysh është data që është vënë në dijeni, por jo më vonë se një vit nga data në të cilën është marrë vendimi. Afati 15-ditor parë më sipër është një afat i parashikuar.
- Dispozitat, për sa i përket përgjegjësisë së ortakëve jorealë, inekzistentë në rregulloren e mëparshme. Kështu, çdo person që pretendon që është ortak ose krijon të tretët duke i bërë në aparençë të besueshëm, përgjigjet tek të tretët me mirëbesim tërësisht si një ortak. Shoqëria nuk do të përgjigjet tek të tretët që e kanë mashtruar, vetëm nëse i ka dhënë motive të mjaftueshme për t'u konsideruar më të drejtë ortak i ri, duke njohur manovrat e ortakut pretendent ajo nuk merr masat e arsyeshme për të ndaluar në çuarjen e të tretit në gabim.
- Dispozitat e reja janë vendosur në kodin e ri civil rumun dhe për sa u përket ortakëve okultë; kështu ortakët përgjigjen tek të tretët me mirëbesim njësoj si ortakët jorealë.

3.2.3 Struktura e kapitalit të shoqërisë

Në Rumani, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 31/1990 ndryshuar dhe ribotuar, kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të jetë më pak se 200 lei dhe ndahet në aksione të barabarta, të cilat nuk mund të jenë më pak se 10 lei, në Shqipëri shuma minimale e kapitalit të shoqërisë është afërsisht 100 lek.

Më poshtë do të analizojmë dispozitat ligjore të zbatueshme për SHPK në Rumani, ku do të nxjerrim në pah dallimet nga sistemi shqiptar.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë, kjo e fundit duke qenë opsionale. Duke qenë se shumatat e lekëve janë të domosdoshme për fillimin e aktiviteteve tregtare, kontributet monetare janë të detyrueshme në themelimin e shoqërive tregtare, pavarësisht nga forma e saj. Kontributi në natyrë mund të ketë si objekt prona të paluajtshme (ndërtesa, instalime etj.), prona të luajtshme personale (materiale, mallra, etj.) të drejta (ushtrimin e një aktiviteti specifik, fonde tregtare, etj.) Këto kontribute realizohen ndërmjet transferimit të të drejtave

përkatëse dhe paradhëniet efektive të mallrave drejt shoqërisë, nëse është fjala për mallra.

Kontributi mund të konsistojë në kalimin e të drejtës së pronës, mallrave ose të drejtën e përdorimit për shoqërinë. Në mungesë të kushteve të përcaktuara, mallrat bëhen pronë e shoqërisë. Kuptohet që, nëse nuk bien dakord në kalimin e të drejtës së pronësisë, malli do të kalojë në pronësi të shoqërisë dhe ortakut nuk do të ketë asnjë të drejtë mbi të. Si pasojë, malli nuk mund të ndiqet nga ortakët kreditorë, por në prishjen e shoqërisë ortakut nuk mund të ketë të drejtën e kthimit të pronës, kjo duke qenë pjesë e shoqërisë.

Nëse kontributi ka si objekt një mall të paluajtshëm ose një mall të luajtshëm, marrëdhënia ndërmjet ortakut dhe shoqërisë është një raport juridik i ngjashëm me atë ndërmjet shitësit dhe blerësit. Për transferimin e të drejtës së pasurisë, Ligji nr. 31/1190 i ndryshuar, parashikon se malli bëhet pronë e shoqërisë “në momentin e regjistrimit të tij në regjistrin tregtar”. Prandaj, në qoftë se malli humbet para regjistrimit të shoqërisë, rreziku merret përsipër nga ortakut. Ai do të jetë i detyruar për të sjellë në shoqëri një mall tjetër, ose një kontribut në të holla ekuivalent me mallin e humbur.

Kontributi në natyrë mund të ketë si objekt të drejta të tilla si: ushtrimi i një aktiviteti specifik, patentat e shpikjeve, markat tregtare, *know-how*. Dëshmi për paradhënien e kontributeve në kapitalin e shoqërisë mund të bëhet, sipas rastit: për kontributin në të holla, pagesa e paradhënies, urdhërpagesa ose fatura e çekut; për kontributet në natyrë nënshkrimi i kapitalit të shoqërisë: titulli i pronësisë (faturat, titujt e pasurisë për pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë dhe certifikatën e mallrave); nëse është rasti, dhe raportin e vlerësimit të mallrave bashkangjitur nga personi i autorizuar sipas ligjit. Raporti i vlerësimit është i detyrueshëm në rastin e SHPK me partner të vetëm.

Dallimet në legjislacionin shqiptar për kontributet në kapitalin e shoqërisë:

- Në të drejtën rumune, vlerësimi i mallrave mund të bëhet me mirëkuptimin e palëve, por në atë shqiptar është e detyrueshme vlerësimi nga eksperti.
- Kujdesi i ligjvënësit shqiptar në rregullimin e detajuar për regjimin e kontributit në natyrë është më madh, për shembull, nuk lejon mallra të pakonsumueshme, nuk është e lejuar kompensimi i të drejtave ndërmjet ortakut dhe shoqërisë tregtare për sa i përket kontributit, dhe së fundmi, është e ndaluar ushtrimi i së drejtës së mbajtjes nga ortakut në raport me shoqërinë debitore kur bëhet fjalë për kontributin e një malli.

Ka një ngjashmëri domethënëse për sa i përket supozimit që në mungesë të çdo specifikimi malli do të konsiderohet i kalueshëm me titullin e pronësisë.

3.2.4 Administrimi

Lidhur me administrimin e shoqërisë, të dyja rregulloret janë të ngjashme, duke evidentuar dallimet e mëposhtme domethënëse: vetëm në ligjin rumun ekzistojnë detaje për sa i përket përgjegjësisë së administratorëve, në sensin e dërgimeve të modelit të kontratës së mandatit, por dhe detajet e rasteve të përgjegjësisë së ndashme/solidare, si dhe ndalimet e grumbullimeve me cilësinë e punonjësit me atë të përfaqësuesit; detyrimet jo-konkurrese, kujdesje, maturi, sinqeritet, konfidencialitet, pavarësi, janë detyrimet e detajuar të administratorëve të përcaktuara me një ligj të veçantë menjëherë me pranimin në BE; Duke marrë konceptin “business judgement rule” në ligjin amerikan, sipas tij, një “vendim biznesi” miratohet në një situatë të supozuar duke qenë në interes të shoqërisë, e mbron administratorin edhe në qoftë se më vonë do të provohet që vendimi ishte i gabuar (në kuptimin për dëmtimin e shoqërisë tregtare).

4. Përfundimet

Shoqëria me personalitet juridik me natyrë kontraktuese, bazuar në një shoqëri të lirë të anëtarëve të saj, ka një histori mijëra vjeçare. Prandaj, mund të themi se shoqëria përfaqëson kategorinë më të rëndësishme të personave juridikë në ekonominë botërore. Zgjerimi dhe vitaliteti i tyre janë zhvilluar, sidomos pas shokut të parë të naftës (1973).

Në kontekstin e legjislacionit tatimor të favorshëm, ritmi i rritjes së numrit të shoqërive ishte veçanërisht i rritur në vendet më të zhvilluara.

Në Rumani, fillimi i procesit të privatizimit të ekonomisë në vitin 1990 risolli në diskutim shoqëritë e çdo regjimi juridik që u modernizuan dhe u plotësuan me ligjet përkatëse.

Qëllimi i këtyre akteve të reja normative është për të adoptuar sistemin ekonomik kombëtar në mekanizmat e ekonomisë së tregut, si dhe për të siguruar funksionimin efektiv të saj përmes ristrukturimit të thellë të formave dhe funksionimeve të agjentëve ekonomikë: domethënë me transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri autonome dhe shoqëri tregtare, si dhe duke krijuar nga iniciativa të veçanta disa njësi fitimprurëse të tipit shoqëri tregtare.

Siç mund të shihet nga sa më sipër, edhe pse ka disa dallime midis rregullave për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në të dy legjislacionet, në atë rumune dhe në atë shqiptare, është e sigurt se të dyja kanë vuajtur për një kohë të gjatë nga modifikimet dhe përpjekjet për të rregulluar në mënyrë që të pozicionohet në limitet e një sistemi të balancuar mes burokracisë dhe lirisë kontratuale, duke ndërhyrë me rregulla të arsyeshme, çdo nevojë e rregullave ka pasur rezultat si nga diferencat ekonomike, sociale dhe kulturore, por edhe nga eksperiencia e praktikës nëpërmjet së cilës çdo shtet ka kaluar në ekonominë e tregut.

REFERENCAT

- 1) Cristian Gheorghe, *Drept comercial comunitar*, Ed. C.H. Beck, București, 2009, p. 66.
- 2) Augustin Fuerea, *Drept comunitar al afacerilor*, Ed. Universul Juridic, București, 2005, pp. 111, 120.
- 3) Maria Dumitru, *Drept profesional. Teoria generală a contractului profesional.*, Ed. Institutului European, Iași, 2011, p. 41.
- 4) Gheorghe Piperea, *Drept comercial*, vol. I, Ed. C.H. Beck, București, 2008, p. 75.
- 5) Gheorghe Piperea, *Drept comercial*, vol. I, Ed. C.H. Beck, București, 2008, p. 76.
- 6) Stanciu D. Cărpenu, Sorin David, Catalin Predoiu, Gheorghe Piperea, *Legea societăților comerciale. Comentariu pe articole.*, ed. a 4-a, Ed. C.H. Beck, București, 2009, p. 6.
- 7) Stanciu D. Cărpenu, *Tratat de drept comercial român*, Ed. C.H. Beck, București, 2007, p. 156; Radu Motica, Lucian Bercea, *Drept comercial român*, Ed. Lumina Lex, București, 2005, p. 90.
- 8) Ioan. Bălan, *Natura juridică a societăților comerciale*, în *Dreptul*, nr. 11/200, p. 36, Marius Scheaua, *Legea societăților comerciale*, nr. 31/1990, comentată și adnotată, Ed. All Beck, București, 2000, pp 21 și urm.
- 9) Octavian Căpățână, *Constituirea societăților comerciale cu personalitate juridică. Faza consensuală*, în *Dreptul*, nr. 7-8/1991, p. 46; Deen Gibirila, *Droit de sociétés*, Ed. Elipses, Paris, 1997, p. 5.
- 10) Yves Guyon, *Traité de contrats. Les sociétés*, ed. a3-a, L.G.J.D., Paris, 1997, nr. 8.
- 11) Yves Guyon, *Traité de contrats. Les sociétés*, ed. a3-a, L.G.J.D., Paris, 1997., p. 80.
- 12) Stanciu D. Cărpenu, Sorin David, Gheorghe Piperea, Catalin Predoiu, *op. cit.*, p. 59; Săche Neculăescu, Mihai Danil, *Contractul de societate*, în *Dreptul*, nr. 56/1994, p. 34.
- 13) Eledio B. Lule, *Starting a Business: Comparative Analysis Between the Republic of Albania and the Republic of Romania*, vol. 2, SCfSD '16, Strugë, p. 139-140.